



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 887, Prot.  
1

Tiranë, më 22.12.2021

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr 85, datë 22.12.2021

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Tea-D" Shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi, në procedurën e prokurimit "Kërkesë për Propozim", me objekt: "*Rrugë të brendshme me beton në lagjen nr. 1 (Amerikane), rruga "Nazif Bezhani", rruga "Sabri Preveza", të zhvilluar në datë 12.04.2021 nga Bashkia Sarandë (në vijim "AK")*".

**I. Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa):** "Tea-D" Shpk me NIPT K32522629L, me adresë: Rruga "Dhuvjan", Nr. Pasurie 3105, Libohovë, Gjirokastër.

**II. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:**

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Tea-D" Shpk, ka nisur mbi bazën e kërkesës së AK, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e subjektit "Tea-D" Shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi, në zbatim të nenit 78/1/a të LPP.

**III. Gjetjet:**

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se nuk ndodheshim në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP.

**IV. Masat:**

Me Vendimin Nr 85, datë 22.12.2021, APP ka vendosur të mospërjashtojë operatorin ekonomik "Tea-D" Shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, pasi nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se, në rastin në fjalë rezultoi e provuar se, operatori ekonomik nuk ka keqinformuar për qëllime kualifikimi autoritetin kontraktor, pasi detyrimi i pretenduar nga AK vjen si rezultat i rekomandimeve të lëna nga organi auditues, rekomandime të cilat janë dhënë për punonjësit që kanë kryer shkelje dhe jo për shoqërinë. Gjithashtu, përveç kësaj, nga

AK nuk provohet se detyrimi i pretenduar vjen si rezultat i një kontrate, i një akti nënligjor apo të një vendimi të formës së prerë të dhënë nga gjykata kompetente.